



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good
Governance

RAPORTI PËR VITIN 2022

**MBI ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024
TË STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE
TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS 2022-2026**

Prishtinë, 2023

Përmbajtja

1	SHKURTESAT	3
2	HYRJE.....	4
3	QËLLIMI I RAPORTIT	5
4	METODOLOGJIA	5
5	PROGRESI I ARRITUR NË ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITET 2022-2026 DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR VITET 2022-2024.....	6
6	PROGRESI NE BAZE OBJEKTIVAVE TE ZBATIMIT TE STARTEGJISE DHE PLANIT TE VEPRIMIT PER PERFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NE SHOQERINE KOSOVARE 2017-2021	10
6.1	Aktivitetet, të arriturat, sfidat dhe rekomandimet.....	10
6.1.1	Arsimi	10
6.1.2	Punësimi dhe Mirëqenie sociale	16
6.1.3	Shëndetësia	20
6.1.4	Banimi	27
6.1.5	Diskriminimi	34
7	RAPORTI I MONITORIMIT PËR VITIN 2022 TË ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TE STRATEGJISE PER AVANCIMIN TE DREJTAVE TE KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NE REPUBLIKEN E KOSOVES 2022-2024.....	48

1 SHKURTESAT

APRK	Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
SFFAKP	Skema e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MATP	Masave Aktive të Tregut të Punës
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publikë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OSBE	Organization for Security and Co-operation in Europe
QAP	Qendra për Aftësim Profesionel në Kosovë
QKMF	Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare
QKSF	Qendra Kryesore e Shëndetësisë Familjare
QPS	Qendrat për Punë Sociale
SIMP	Sistemit elektronik Ministrise se Punës
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve të Arsimit
SNS	Skemës së Ndihmës Sociale
UA	Udhëzimin Administrativ
UNDP	United Nations Development Programme
VoRAE	Voice of Roma, Ashkali and Egyptians
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
ZQM / ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit

2 HYRJE

Ky Raport vjetor është hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit për zbatimin e Strategjisë për vitin 2022 për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024.

Raporti paraqet gjendjen faktike reale të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare përmes vlerësimit të zbatimit të aktiviteteve nga institucionet e Kosovës dhe ndikimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit të përmirësimit të gjendjes dhe situatës arsimore, socio ekonomike, kulturore, shëndetësore të komuniteteve rom dhe ashkali.

Më 20 korrik 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 89-të me Nr.02/89 me 20.07.2023 miratoi Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024.

Strategjia ka si objektive rritjen efektive të ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës; rritjen e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe uljen e varfërisë; përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore; rritjen e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike; dhe parandalimin dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjyqimeve, stereotipeve, dhe bullizmit për komunitetin Rom dhe Ashkali.

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024 paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve.

Strategjia gjithashtu është hartuar në bazë të Kornizës BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat adresohen në Strategji: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi. Këto fusha paraqesin prioritetet me të cilat duhet të ballafaqohet zbatimi i Strategjisë, dhe ndër vepronjë me njëra tjetrën. Në shumicën e rasteve paraqesin edhe shkaqe edhe rrjedhoja apo efekte të njëra-tjetrës, prandaj është jetike të punohet në secilën në mënyrë që të arrihen rezultate efektive. Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është definuar një objektivi strategjik. Secili objektivi strategjik është zbërthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planin e Veprimit janë zbërthyer në rezultate dhe në aktivitete.

Përmbushja e këtyre objektivave do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit është një çështje kyçe për të siguruar një pasqyre për gjendjen e këtyre komuniteteve dhe relacion me institucionet e Kosovës në pesë fusha të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e veprimit sipas standardeve evropiane.

Buxheti është kryesor për arritjet e objektivave të synuara nga Qeveria e Kosovës. Institucionet e Kosovës me aprovimin e këtij plan veprimi janë zotuar për ndarjen e buxhetit sipas plan veprimit. Në raport mund të gjendet buxheti i Kosovës; buxheti i shpenzuar nga institucionet e Kosovës për realizimin e përgjegjësive që dalin nga plani veprim e pranuar nga Qeveria e Kosovës.

Sidoqoftë, për të qenë efektiv, procesi i hartimit të politikave varet nga përcjellja e rregullt e progresit drejt objektivave dhe zbatimit të masave individuale, dhe vlerësimeve të rregullta. Monitorimi është mbledhja dhe analiza rutinore e informacionit për të përcjellë progresin kundrejt planeve të vendosura dhe kontrollimit të përputhshmërinë me standardet e vendosura. Ky ndihmon në identifikimin e trendeve dhe modeleve për të përshtatur politikat dhe strategjitë dhe për t'i përmirësuar ato.

Raporti vjetor për vitin 2022 të zbatimit të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024 me një monitorim të mirëfillt shtjellon arritjet, sfidat dhe ndikimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit.

3 QËLLIMI I RAPORTIT

Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024 është multisektorial dhe përshinë një fushëveprim të gjerë. Prandaj hartimi i raporti të këtij Plan Veprimi ashtu është shumë dimensional.

Raporti ka për qëllim që të vë në pah aktivitetet që janë ndërmarr dhe vazhdojnë të ndërmerren në drejtim të realizimit të objektivave të përmbajtura në pesë fusha të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024; në Arsim, Punësim dhe mirëqenie sociale, shëndetësi, banim dhe diskriminimi. Gjithashtu në kuadër të raportit përveç vlerësimit që është bërë në pesë sektorë në bazë të objektivave të Planit të Veprimit, po ashtu, është bere edhe identifikimi i problemeve, sfidave në zbatimin e aktiviteteve të përfshira në Plan Veprim.

Ky Raport do shërbejë më tutje, për institucione të Kosovës, si një udhërrefyës për identifikimin e objektivave, që janë të zbatueshme dhe identifikimit e sfidave nga institucionet e Kosovës në zbatimin e Planit të Veprimit dhe për të marr hapa konkrete për tejkalimin e sfidave nga institucionet e Kosovës.

4 METODOLOGJIA

Zyra për Qeverisje të Mirë ka rol kryesor në procesin e koordinimit dhe monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit.

Monitorimi është një çështje kyçe për zbatimin mirëfilltë të dokumenteve. Për një monitorim me efikas është hartuar korniza e monitorimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit, është përcaktuar metodologjia e mbledhjes së informacioneve përmes kornizës monitorues, e cila mundëson grumbullimin e statistikave dhe të dhëna konkrete, ku mundësohet një matshmëri të zbatimit të Planit të veprimit.

Kjo Kornizë Monitorues të avancuar e përdorur nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër Zyrën e Kryeministrit për mbledhjen e të dhënave për hartimin e raportit ka mundësuar një vlerësim të progresit të arritur të zbatimit të Planit të Veprimit.

Gjatë hartimit të Raportit vjetor për zbatimin e aktiviteteve të Planit të veprimit informatat janë përmbledhur nga pikat e kontaktit në ministri përmes dërgimit të informacioneve në mënyrë elektronike duke plotësuar kornizën monitoruese.

Kjo metodë ka rezultuar me një pasqyrë shumë të qartë ku janë vërejtur të arriturat dhe ngeçjet, apo edhe sfidat në zbatimin e Planit të veprimit.

5 PROGRESI I ARRITUR NË ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITET 2022-2026 DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR VITET 2022-2024

Progresi i arritur në pesë fusha të Strategjisë dhe Planit të veprimit është si në vijim:

Raporti vjetor për vitin 2022 e hartuara përmes të dhënave të siguruara nga institucionet e Kosovës kanë dëshmuar që zbatimi i Strategjisë dhe Plani i veprimit kishte një efekt thelbësor pozitiv përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në sistemin e arsimit gjegjësisht në rritjen e numrit të nxënësve dhe studentëve në arsim, në përfshirjen e më të varfërve në skemat e mbrojtjes sociale, në përmirësimin e qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe banimit dhe në luftimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Nder këto arritje punësimi i këtyre të komuniteteve mbetet ende sfidë, punësimi është një sfidë edhe për të gjithë shoqërinë kosovare.

Arsimi

Në sektorin e arsimit ka pasur arritje konkrete si në regjistrimin dhe frekuentimin e anëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në të gjithë nivelin e arsimit gjatë vitit akademik 2022-2023. Gjithashtu për të stimuluar nxënësit për shkollim të mesëm MASHTI si çdo vit Shkollor edhe për vitin 2022 ka ndarë 498 bursa për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët kanë plotësuar kriteret. Shuma e ndarë gjithsej është 149.400.00 euro.

Gjithashtu kanë përfituar edhe 26 studentë të regjistruar në vitin e parë të studimeve të cilëve MASHTI ju ka ndarë bursa në vlerë prej 1000 euro për student, shuma totale 26.000 euro.

Gjatë vitit 2022 bazuar në informatat nga terreni dhe nga OJQ-të, ekipi i EPRMB në nivel qendror ka reaguar dhe ka bashkëpunuar me DKA-të lidhur me 5 nxënës të raportuar si braktises apo edhe të mosregjistruar në shkollë nga komuna e Pizren-it.

Ndërsa OJQ VORAE do të implementoj programin e mentorimit në 8 komuna me gjithsej 19 shkolla që do të mbështet 304 nxënës dhe do të angazhohen 64 mentor. Komunitetet ku do të realizohen programi i mentorimit janë Ferizaj, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Pejë, Shtime, Klinë dhe Mitrovicë.

Gjithashtu si rezultat i rritjes së përfshirjes në arsim janë edhe qendrat mësimore që shihen si një e arritur e rëndësishme në rritjen e përfshirjes në arsim, për parandalimin e braktisjeve të shkollimit dhe për përmirësimin e suksesit të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar edhe 20 qendra mësimore, deri me tani janë regjistruar gjithsej 38 qendra mësimore. Themelimi dhe funksionimi edhe i 20 qendrave mësimore që mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Punësimi

Qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa në fusha të ndryshme për avancimin e të drejtave të komuniteteve dhe përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike si në punësimi, edukim dhe për parandalimin dhe zvogëlimin e diskriminimit për qytetarët e saj e me theks të veçantë për komunitetet. Informimi i përfaqësuesve të komuniteteve për këto masa është kryesor.

Zyrën për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Zyra për Çështje të Komuniteteve / Zyra e Kryeministrit ka organizuar një takim informues me 07 tetor 2022, ku kanë marr pjesë për zyrtarët komunal dhe shoqërinë civile me 07 tetor 2022 me qëllim prezantimin e nismave të reja për t'iu dalë ndihmë qytetarëve në kohë krizë “ Një të punësuar përçdo familje” dhe Pakoja “për përballje në inflacion” “Programi i Komisionit Evropian mundësia për Master jashtë vendit - Projekti Youngcell” dhe prezantimin e Platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

APRK për nxitjen e regjistrimit dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale konform nevojave të tregut të punës ka arrit një marrëveshje me VORAE, dhe organizata tjera, ku është mundësuar një informim për shërbimet e punësimit dhe aftësimin profesional. Si rezultat në 2022 në aftësimin profesional janë përfshirë gjithsej 104 persona nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian; Rom 52, ashkali 24 dhe egjiptian 28.

Shëndetësia

Objektivi kryesor u arrit me sukses sepse aktiviteti adresoi mungesën e seancave të disponueshme të ndërgjegjësimit të shëndetit riprodhues dhe siguroi falas mamografi celular për gratë që po përballen me pengesa të shumta në qasjen në mamografi.

Ministria e Shëndetësisë në perkahje të OSBE-së organizuan seanca të shëndetit riprodhues dhe sigurimin e skanimeve të mamografisë celulare për gratë dhe vajzat e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe bosniak me 14 -22 Nëntor dhe 12-14 Dhjetor 2022 në 5 Komuna (Prizren, Mitrovicë, Gjakova, Peja, Prishtinë dhe Ferizaj), në 11 lokacione Brekoc- 32 pjesëmarrës, Ali Ibra- 43, Peja/pec 7 Shtatori- 42, Salahanne- 46, Dubrava - 40, Gjilan - 40, Prizren - 36, Prizren Bosnja Mahalla - 18, Priluzje - 23, Roma Mahalla Mitrovicë/A - 40, FKP/PR - 30). Për shkak të interesit më të lartë, mamografia u kthye dy ditë në Prizren dhe 1 ditë në Ferizaj midis 12 dhe 14 Dhjetor 2022.

Nga ky projekt kanë përfituar 390 gra të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Përmes ekzaminimeve të rregullta të mamografisë gratë janë informuar edhe për parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, shtatzënitë e shëndetshme, lindjet dhe menopauzën e shëndetshme. 116 Gratë morën falas mamografi me rezultate dhe rekomandime të hollësishme nga specialisti i radiologjisë. 10 gra nuk hynë në mamografi, u refuzuan për arsye shëndetësore. Sondazhi i kryer para secilës seancë shëndetësore demonstroi se 78% e grave pjesëmarrëse nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë nuk kanë pasur kurrë një skanim të gjirit. Pothuajse gjysma e grave që morën pjesë, 46% nuk kishin ekzaminime të rregullta gjinekologjike.

Gjinekologu i kualifikuar prezantoi seanca të shëndetit riprodhues, ku morën pjesë 390 gra dhe vajza që i përkasin komuniteteve roma, ashkali, egjiptian dhe boshnjak. Janë shpërndarë 400 komplete që përmbajnë një muaj me vlerë furnizimin e sendeve higjienike për familjen, të cilat do të zvogëlojnë nivelin e varfërisë higjienike të familjeve të marginalizuara dhe të cenushme.

Sipas raportit të IKSHPK janë realizuar trajnimet me profesionistët shëndetësorë për "Viziat Shtëpiake", Mbi 650 prindër kanë marrë pjesë në këto sesione, të fasilituar nga mjekë familjarë nga Kujdesi Parësor Shëndetësor, përfshirë modulën e rëndësisë së vaksinimit. Janë realizuar gjithsej 143 sesione të vaksinimit mobil në 16 komuna për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

IKSHPK ka bërë identifikimin i fëmijëve të pa vaksinuar nga komunitet rom, ashkali dhe egjiptian përmes vizitave "derë me derë". Përmes kampanjës "derë më derë" janë vizituar 9,149 fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Janë identifikuar si të pa vaksinuar 2,548 fëmijë (48% vajza), të cilët janë vaksinuar përmes kampanjës së vaksinimit mobil "catch-up vaccination". 458 fëmijë janë vaksinuar me vaksinën MMR.

Banimi

Në planin legjislativ është paraparë hartimi i projekligjit për banim social. Gjatë vitit 2022 Grupi Punues Ndërministror ka vazhduar hartimin e projektligjit për Banim Social.

Konsultimet me publikun janë mbajtur në periudhën 26.07-16.08.2022, ku janë pranuar komentet nga 13 Institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësior dhe Infrastruktues (MMPHI) në bashkëpunim me UN-Habitatin dhe me Institucionet tjera ndërkombëtare ka hartuar dhe aprovuar "Studim

Fizibiliteti për Programin e Banim Social Adekuat (shkurt 2022)”. Studim Fizibiliteti për Programin e Banim Social Adekuat është përkrahur nga CEB-Banka.

Nga CEB-Banka është aprovuar kërkesa për kredi me interes të ulët prej 25.0 mil euro për bashkëfinancimin e Projektit të Banimit Adekuat Social. Në vitin 2023 pritet të bëhet ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Diskriminimi

Më aprovimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali komuniteteve në fjalë i është afuar mundësi të barabarta për zhvillim dhe punësim.

Strategjia është miratuar më 20.07.2022 dhe ka si objektive rritjen efektive të ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës; rritjen e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe uljen e varfërisë; përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore; rritjen e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike; dhe parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimeve, stereotipeve, dhe bullizmit për komunitetin Rom dhe Ashkali.

Kjo Strategji paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve. Kjo Strategji synon të plotësojë hendekun e komuniteteve Rom dhe Ashkali, që përfshinë por nuk kufizohet në fushat: arsimin, punësimin dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit dhe diskriminimit.

Me datë 01.06.2022, Qeveria ka marrë Vendim Nr. 6/81 me 01.06.2022 për themelimin e Ekipit ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimin për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës. Duhet cekur që, themelimi i Ekipit është masë e përkohshme afirmative, për nxitjen dhe promovimin si dhe për arritjen e kuotës së punësimin të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, siç përcaktohet në Kushtetutë, në Ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës. Është më së e nevojshme të theksohet po ashtu që krijimi i këtij mekanizmi ishte edhe si kërkesë e Deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian (5 korrik 2019), e njohur si Deklarata e Poznanit. Kjo deklaratë të cilën e ka nënshkruar edhe Republika e Kosovës e cila qëndron në zotimet për arritjen e objektivave të saj dhe si rrjedhojë duhet të angazhohet të vazhdojë dhe forcojë përpjekjet për barazi të plotë dhe integrim të romëve duke përfshirë edhe ashkalitë dhe egjiptianët.

Me datë 22 qershor 2022, është lansuar Platforma Kombëtare për Raportimin e Rasteve të Diskriminimit ndaj Komunitetit Rom, Ashkali dhe. Qëllimi i platformës është të kontribuojë në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke ofruar qasje më të lehtë për qytetarët për të raportuar rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe referimin e tyre në institucionet përkatëse. Është një rast unik, në

rajon e më gjërë që një Qeveri të hapë një platformë për t'u mundësuar qytetarëve të raportojnë rastet e mundshme të diskriminimit.

Është duke funksionuar Grupi Punues teknik për mbrojtjen nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Qëllimi i krijimit të Grupit teknik të punës është zbatimi i përgjegjësive që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ka organizuar më 7 nëntor 2022 Samitin Rajonal Kundër Diskriminimit Racor, me qëllim të shkëmbimit të përvojave me qeveritë e vendeve të rajonit, lidhur me veprimet që kanë ndërmarrë për të parandaluar dhe luftuar racizmin dhe diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe për të diskutuar mënyrat për të thyer ciklin e përjashtimit social. Slogani i Samitit ishte "Së bashku dhe të barabartë".

6 PROGRESI NE BAZE OBJEKTIVAVE TE ZBATIMIT TE STARTEGJISE DHE PLANIT TE VEPRIMIT PER PERFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NE SHOQERINE KOSOVARE 2017-2021

6.1 Aktivitetet, të arriturat, sfidat dhe rekomandimet

6.1.1 Arsimi

Objektivi strategjik 1: Krijimi i ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali

Objektivi specifik 1.1: Vetëdijesimi dhe promovimi i rëndësisë së arsimimit dhe përfshirjes të fëmijëve nga komunitetet Rom dhe Ashkali në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë.

Sipas SMIA-MASHTI të dhënat e regjistruara në vitin akademik 2022/2023 përfshijnë tregues specifik gjinor për shumicën e të dhënave themelore siç janë regjistrimi I nxënësve;

Nr. I nxënësve rom,	F. 509,	M. 530,	Gjithsej 1039
Nr. I nxënësve ashkali	F. 1914,	M. 2051,	Gjithsej 3965
Nr. I nxënësve Egjiptian	F. 633,	M. 110,	Gjithsej 3306

Total: 6362

Tabela 1. Nxënësit sipas përkatësisë etnike 2022/2023

Nxënësit sipas përkatësisë etnike, 2022/23,total												
Niveli	Ashkalinjë			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Arsimi parashkollor (mosha 0-<5)	0	3	3	4	10	14	1	1	2	5	14	19
Arsimi parafillor (mosha 5-<6)	111	112	223	43	30	73	45	39	84	199	181	380
Fillor/ mesem i ulët	1846	1732	3578	447	437	884	569	516	1085	2862	2685	5547
I mesem i lartë	94	67	161	36	32	68	110	77	187	240	176	416
Gjithsej	2051	1914	3965	530	509	1039	725	633	1358	3306	3056	6362

Udhëzimi administrative ofron lehtësira për grupet e cenueshme në regjistrim në institucionet parashkollore.

Arsimi fillor është i obligueshëm dhe nuk i mohohet askujt e drejta për shkollim. Ndërsa regjistrimi në arsimin e mesëm të lartë bëhet me mirëkuptim të DKA-ve, të cilët çdo vit ofrojnë lehtësira për regjistrim në shkollat e mesme të larta, kjo formë e regjistrimit aplikohet çdo vit Shkollor duke pasur parasysh bashkëpunimin MASHTI -DKA.

Gjithashtu për të stimuluar nxënësit për shkollim të mesëm MASHTI çdo vit Shkollor ndan edhe bursa për 500 nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Si rezultat i rritjes së përfshirjes në arsim janë edhe qendrat mësimore që shihen si një e arritur e rëndësishme në rritjen e përfshirjes në arsim, për parandalimin e braktisjeve të shkollimit dhe për përmirësimin e suksesit të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë. Qendrat Mësimore ofrojnë edukim parafillor, si dhe ofrojnë mësim shtesë, orë plotësuese, ndihmë për kryerje të detyrave të shtëpisë për nxënësit e arsimit të obligueshëm si dhe aktivitete të tjera sociale e edukative për fëmijët dhe nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian. Përveç këtyre, Qendrat Mësimore shpeshherë shërbejnë edhe si urë lidhëse ndërmjet familjeve, komunitetit dhe institucioneve edukativo-arsimore.

Ekipet për parandalim të braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë janë funksionale dhe në vazhdimë janë duke punuar në këtë drejtim. Gjatë vitit 2022 bazuar në informatat nga terreni dhe nga OJQ-të, ekipi i EPRMB në nivel qendror ka reaguar dhe ka bashkëpunuar me DKA-të lidhur me 5 nxënës të raportuar si braktisjes apo edhe te mosregjistruar në shkollë nga komuna e Pizrenit.

Në bazë të masave të marra dhe angazhimit të institucioneve të Kosovës MASHTI-Shkolla dhe Ekipit numri i nxënësve të braktisur nga viti shkollor 2020/2021 ka ra dukshme në vitin shkollor 2021/2022 si në tabelat në vijim. Në vitin shkollor 2020/2021 braktisja ishte 134 dukshem në vitin shkollor 2021/2022 ishte në vitin 106, detajet mund të shihen në tabela.

Tabela2: Nxënës braktisës, 2020/21

Klasë	Ashkalinjë			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Kl. 1-9	27	25	52	3	0	3	6	2	8	36	27	63
Kl. 10-12	0	0	0	0	0	0	3	1	4	3	1	4
Gjithsej	27	25	52	3	0	3	9	3	12	39	28	67

Tabela 3: Nxënës braktisës, 2021/22

Klasë	Ashkalinjë			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Kl. 1-9	22	18	40	0	1	1	6	4	10	28	23	51
Kl. 10-12	1	1	2	0	0	0	0	0	0	1	1	2
Gjithsej	23	19	42	0	1	1	6	4	10	29	24	53

Mësimi plotësues të gjuhës rome është duke organizuar në Prizren. MASHTI përveç komunës së Prizren-it nuk ka marr ndonjë kërkesë nga komuniteti nga komunat tjera se dëshirojnë mësim plotësues të gjuhës rome. MASHTI planifikon që bazuar në kërkesat e komuniteteve të zgjeroj mësimin plotësues të gjuhës rome edhe në disa komuna tjera.

Për vitin 2022 janë ndarë 498 bursa për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët kanë plotësuar kriteret. Shuma e ndarë gjithsej është 149.400.00 euro.

Gjithashtu kanë përfituar edhe 26 studentë të regjistruar në vitin e parë të studimeve të cilëve MASHTI ju ka ndarë bursa në vlerë prej 1000 euro për student, shuma totale 26.000 euro.

Tabela 4: Përfituesit e bursës 2022/2023

Nr.	Përfituesit	Suksesi (mesatarja e notës)	Rom		Ashkali		Egjiptian	
			F	M	F	M	F	M
	498	3.0	36	34	105	115	102	106

Çdo vit OJQ-të bëjnë mentorimin e 50 studentëve

Projekti INCLUDE ka ndarë grante për 2 OJQ të cilët do të bëjnë mentorimin dhe tutorimin e 600 nxënësve të shkollave të mesme të larta duke përfshirë edhe përfituesit e bursës nga MASHTI. OJQ RVK e ka programin e mentorimit në nivel nacional ndërsa tutorimi do të bëhet në 5 komuna siç janë: Prizren, Gjakovë, Pejë, Obiliq dhe Graçanicë. Ndërsa OJQ VORAE do të implementoj programin e mentorimit në 8 komuna me gjithsej 19 shkolla që do të mbështet 304 nxënës dhe do të angazhohen 64 mentor, komunat ku do të realizohet programi i mentorimit janë Ferizaj, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Pejë, Shtime, Klinë dhe Mitrovicë.

Tabela 5 : Të dhëna sipas tipit të shkollës për arsimin e të rriturve

Tipi shkollës	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Gjithsej ne gjimnaze	12	13	25	17	12	29	9	15	24	38	40	78

Tipi shkollës	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Gjithsej ne shk. Profesionale	82	54	136	19	20	39	101	62	163	202	136	338

SHML	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Gjithsej	94	67	161	36	32	68	110	77	187	240	176	416

MASHTI ka organizuar fushatë për orientim në karrier me moton dyert e hapura e cila organizohet çdo vit shkollor në javën e fundit të muajit prill për të gjithë nxënësit.

Është ofruar tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Furnizimi me tekste shkollore është realizuar për të gjithë nxënësit e arsimit të obliguar pa dallime. Numri i nxënësve që janë furnizuar me tekste për vitin shkollor 2022/2023 është 884 nxënës rom, ashkali 3578 nxënës dhe egjiptian 1085 nxënës.

Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim.

Bazuar në kërkesat dhe nevojën për institucionalizimin e qendrave mesimore MASHTI ka hartuar udhëzimin administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mesimore dhe gjithashtu ka hartuar edhe udhëzuesin për implementimin e këtij udhëzimi administrativ.

Ky udhëzim administrativ përcakton kriteret dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të qendrave mesimore.

Qëllimi i qendrave mesimore është të ofrojne mbështetje me mësim plotësues për nxënësit që kanë nevojë në mësim dhe gjithashtu ofrohen edhe aktivitete të tjera edukative arsimore.

Ekzistojnë qendra mesimore me bazë në shkollë dhe me bazë në komunitet, qendrat mbështesin nxënësit e nivelit parafillor, fillor dhe nivelit të mesëm të ulët.

MASHTI në qershor të vitit 2020 në web faqe ka shpallur njoftimin për regjistrimin e qendrave mesimore në MASHTI dhe ky njoftim vazhdon të jetë i hapur. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar edhe 20 qendra mesimore, deri me tani janë regjistruar gjithsej 38 qendra mesimore.

Për vitin 2022 MASHTI ka ndarë buxhet në vlerë prej 200.000 euro për mbështetjen e OJQ-ve që drejtojnë qendra mesimore që mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Thirrja publike për financimin e OJQ-ve që drejtojnë qendra mesimore është shpall me 15 prill 2022 dhe ka përfunduar me 20 maj 2022. Kanë aplikuar 15 OJQ, Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e projektpropozimeve të OJQ-ve ka përzgjedhur 5 OJQ fituese me gjithsej 14 qendra mesimore, të cilat i kanë plotësuar kriteret.

Buxheti i planifikuar është realizuar në tërësi. Implementimi i projektpropozimeve nga OJQ-të fituese fillon nga muaji shtator 2022.

Gjithashtu edhe përmes projektit INCLUDE janë ndarë grante për OJQ për organizimin e shkollave verore dhe dimërore për nxënësit e këtyre komuniteteve.

Më datë 28.11.2022 është mbajtur një takim me përfaqësues të komunitetit rom dhe njohës të gjuhës rome lidhur me planprogramet dhe tekstet ekzistues të gjuhës rome.

Në Prizren është realizuar takimi në formë të tryzës së rrumbullakët e organizuar nga MASHTI me rastin e javës së gjuhës rome e cila u mbajt në muajin nëntor. Në takim morrën pjesë 24 persona të komuniteteve rom ndërsa nga përfaqësuesit e institucioneve arsimore morrën pjesë zyrtarja nga MASHTI dhe udhëheqja e DAK në MASHTI.

Qëllimi i takimit ishte mundësia për Rishkimin e planit dhe programit mësimor ekzistues për gjuhën dhe kulturën rome dhe mundësia dhe nevoja për rishikimin e teksteve ekzistuese shkollore për mësimin e gjuhës rome Romani Chib 1, 2, 3.

Në takime të ndryshme me OJQ-të janë informuar se ekziston UA që ofron lehtësime për regjistrimin në institucione parashkollore. MASHTI çdo vit mbanë sesione informuese lidhur me rendësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe informimin e komuniteteve lidhur me ekzistimin e UA 16/2020 për lehtësimet që ofrohen në regjistrimin e fëmijëve nga grupet e cenueshme.

Objektivi specifik 1.3: Luftimi dhe parandalimi i racizmit, bullizmit dhe diskriminimit në shkolla dhe promovimi i kulturës dhe historisë së komuniteteve Rom dhe Ashkali

Rrjedhimisht, një propozim për një program mbështetës u zhvillua nga projekti INCLUDE.

- Është zhvilluar një program trajnimi mbi krijimin e një komuniteti të nxënimit demokratik dhe gjithëpërfshirës në shkolla dhe më pas është akredituar nga MASHTI. Programi përbëhet nga tri pjesë: një hyrje në Kornizën e Referencës së Këshillit të Evropës mbi kompetencat për kulturën demokratike, trajtimin e bullizmit në shkolla dhe mbrojtjen e mjedisit. Dy manuale, një për mësuesit dhe drejtorët e shkollave dhe një tjetër për trajnuesit janë zhvilluar dhe botuar në shqip, anglisht dhe serbisht. Manualët iu shpërndanë të gjitha ekipeve të shkollës në fillim të trajnimit.

- 24 shkolla pilote janë përzgjedhur përmes procedurës konkurruese dhe janë përfshirë në projekt. Në secilën shkollë u krijuan ekipe prej 10-12 pjesëmarrësish, të përbëra nga drejtori i shkollës (dhe zëvendësdrejtori sipas rastit), mësues të nivelit parafillor, si dhe të nivelit fillor, duke përfshirë asistentë mësimdhënës, një psikolog, pedagog dhe një prind. përfaqësues i këshillit. Këto ekipe marrin pjesë në aktivitetet e projektit dhe mbështeten për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse.

- 240 profesionistë të shkollave nga 24 shkolla pilot të përfshira në projekt, duke përfshirë mësues të nivelit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët, psikologë, menaxhmentin e shkollës dhe përfaqësues të këshillave të prindërve, e kanë përfunduar trajnimin mbi kulturën demokratike dhe gjithëpërfshirëse në shkolla në qershor 2022.

Janë hartuar dy manuale të cilat janë aprovuar nga MASHTI për kulturën demokratike, trajtimin e bullizmit në shkolla dhe mbrojtjen e mjedisit.

Rekomandimet për Sektorin e Arsimit

- MASHTI duhet të vazhdojë më tej të sigurojë bursa të paktën në nivelin e viteve të kaluara.
- Për të rritur pjesëmarrjen në arsimin parashkollor rekomandohet që të trajtohet kjo çështje duke ndërmarrë më shumë fushata ndërgjegjësimi, qasje të personalizuar për familjet e fëmijëve, ndërhyrje në shënjestër me familjet e fëmijëve që nuk regjistrohen në arsimin parashkollor.
- MASHTI duhet të fillojë mbledhjen e të dhënave dhe raporteve nga donatorët aktivë në sektorin e arsimit për kontributet e tyre të dhëna dhe shpenzimet e bëra në masat e strategjisë.
- Të vazhdohet më institucionalizimin e Qendrava mësimore me bazë komunitare dhe të alokohet buxheti në bazë të nevojave operationale.
- Sektori i punësimit theksoi nevojën e organizimit dhe ofrimit të kurseve të gjuhës shqipe për pjesëtarët e komunitetit rom dhe ashkali për të rritur aftësitë dhe shanset e tyre për punësim.

6.1.2 Punësimi dhe Mirëqenie sociale

Objektivi strategjik 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali.

Objektivi specifik 2.1 Përmirësohet qasja në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional.

Qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa në fusha të ndryshme për avancimin e të drejtave të komuniteteve dhe përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike si në punësim, edukim dhe për parandalimin dhe zvogëlimin e diskriminimit për qytetaret e saj e me theks të veçantë për komunitetet. Informimi i përfaqësuesve të komuniteteve për këto masa është kryesore.

Zyrën për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Zyra për Çështje të Komuniteteve / Zyra e Kryeministrit ka organizuar një takim informues me 07 tetor 2022 ku kanë marr pjesë për zyrtarët komunal dhe shoqërinë civile. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i nismave të reja për t'iu dalë ndihmë qytetarëve në kohë krize “ Një të punësuar përçdo familje” dhe Pakoja “për përballje në inflacion” “Programi i Komisionit Evropian mundësia për Master jashtë vendit - Projekti Youngcell” dhe prezantimin e Platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Zyra për Çështje të Komuniteteve / Zyra e Kryeministrit ka ndarë 10 grante gjatë vitit për aktivitete që e promovojnë punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali.

Në projekt për praktikantë të ri me theks të veçant tek komunitetet, ZÇK-ja ka ofruar 100 vende për praktikantë në institucionet.

APRK për nxitjen e regjistrimit dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale konform nevojave të tregut të punës ka arrit një marrëveshje me VoRAE, dhe organizata tjera, ku është mundësuar informimi i pjesëtarëve për shërbimet e punësimit dhe aftësimin profesional. Si rezultat në 2022 në aftësim profesional janë përfshirë gjithsej 104 persona nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian; rom 52, ashkali 24, dhe egjiptian 28.

Për të nxitur vetëpunësimin është bërë subvencionimi në punësim afatgjatë të komuniteteve rom dhe ashkali në sektorin privat. Numri i përfshirë në subvencionim në pagë gjatë vitit 2022 ishte 26 persona, ku prej tyre : rom 7, ashkali 10 dhe egjiptian 9.

Përfshirja e komuniteteve rom, ashkali është një prioritetet e Qeverisë së Kosovës. Nga APRK janë angazhuar me pagesë pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në praktikë në punë dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal. Përfitues ishin 3 persona, rom 1, ashkali 1, egjiptian 1.

Gjithashtu janë angazhuar 3 pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali në trajnim në punë (kosto për kandidat 3x170). Përfitues në masën trajnim në punë ishte 3 ashkali.

Rritja e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërmjetësimit në punësim është një ndër synimet të Planit të veprimtimit ku numri i të ndërmjetësuarve në punësim të rregullt ishte 55; rom 17, ashkali 33, egjiptian 25.

APRK gjatë vitit 2022 me qëllim të informimit të qytetareve për ofrimin e shërbimeve të punësimit përmes SIMP sistemi informativ i menaxhimit të punësimit janë mbajtur panairt e punës ku janë bërë edhe prezantimi i shërbimeve të punësimit dhe aftësimin profesional.

Inicimi dhe promovimi i programeve të veçanta të trajnimit për të drejtat e komuniteteve është realizuar edhe nga AKSP me 05.07.2022 me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Europian/OSBE në Kosovë. Punëtorja është realizuar për të inkurajuar të rinjtë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të aplikojnë në konkursin e Policisë së Kosovës. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 30 pjesëmarrës nga komunitetit rom dhe ashkali.

Objektivi specifik 2.2 Përmirësohet kualiteti i jetës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali të papunësuar përmes përfshirjes së tyre në programet e mbrojtjes të skemave dhe shërbimeve sociale.

Gjatë 2022, janë trajnuar mbi 60 trajner të shërbimeve sociale familjare, të cilët do të zhvillojnë materialet/modulet dhe do të ofrojnë trajnime për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare pa dallim etnie.

Gjatë periudhës raportuese, janë trajnuar ofrues të shërbimeve sociale familjare, punëtorë social të tre niveleve nga sektori qeveritar dhe joqeveritar nga të gjitha komunitete pa dallim etnie.

Zhvillimi programit për dy strehimet familjarë: strehimin familjare brenda familjes, strehimin familjar alternativ, si dhe në skemën e SFFAKP.

Ministria përkatëse përmes QPS-ve ka siguruar strehim familjar për të gjitha komunitetet, përfshirë fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian.

Rezultatet e arritura bazuar në të dhënat e data bazës së Shërbimeve Sociale, gjatë vitit 2022, një numër i përgjithshëm prej 49 fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë vendosur në strehim familjar tek të afërmit ndërsa 3 fëmijë janë vendosur në strehimin familjar alternativ jashtë familjes.

Po ashtu është realizuar pagesa për Skemën e Familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershëm 1-18 vjeç për 113 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian me pagesë mujore 100 euro.

Në çdo QPS dhe institucione gjegjëse ekzistojnë fletushka informuese si për ofrimin e shërbimeve sociale, ashtu edhe për të drejtat e përfituesve të Asistencës sociale, kategoritë sociale dhe format mbrojtëse.

Mbrojtja ndaj kësaj kategorie konsiston në ofrimin e shërbimeve 24 orë-she duke përfshirë: strehimin, ushqimin, veshmbathjen, ofrimin e shërbimeve shëndetësore, akomodimin dhe të gjitha shërbimet e tjera të vlerësuara si të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, prapambetje mendore.

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve, janë ofruar shërbime rezidenciale 24-orës për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara nga Instituti Special në Shtime, Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë dhe (13) Shtëpi të komuniteteve në shtrirje nëpër komunat e Kosovës. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfituar mbi 273 rezidentë/klientë të vendosur në këto institucione nga të gjitha komunitetet pa dallim etnie e vetëm nga komuniteti rom, ashkali egjiptian janë 11.

Nga Komuniteti rom, ashkali, egjiptian nuk kemi Organizata Joqeveritare të Licencuara, arsyeja është mos aplikimi i tyre bazuar në shpalljen publike nga Ministria.

MFPT për periudhën e vitit nëntor 2021 deri nëntor 2022 ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare/entitetet të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori e cenueshme të shoqërisë përmes pakove ushqimore. Në kuadër të saj janë 54 organizata përfituese në shumë prej 2,304,545.10 euro. 54 organizata përfituese në shumë prej 2,304,545.10 euro.

DPSF ka realizuar marrëveshje dhe kontrata për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me të gjitha strehimoret në nivel nacional. Të gjitha këto strehimore gjatë vitit 2022 kanë strehuar dhe kanë trajtuar me shërbime të nevojshme viktimat e dhunës në familje të të gjitha moshave dhe nacionaliteteve.

DPSF-ja ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre: strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje. DPSF-ja ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre:

strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje. 81 viktima të strehuara në këto strehimore janë nga Komunitetet rom, ashkali, egjiptian.

DPSF-ja ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre: strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje. MFPT ofron ndihmë sociale për të gjitha komunitetet në Kosovë, përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

MFPT ka nxjerrë vendimin me Nr. 05-1/2022 të Dt. 27/01/2022, ku pagesa minimale është 70 euro për një anëtar në SNS dhe maximale është 250 euro me se shumti pa varësisht numrit të anëtarëve të familjes në SNS.

Skema e ndihmave sociale menaxhohet nga Qendrat për punë sociale, vendimmarrja në përzgjedhjen e rasteve nga QPS ndërsa hartimi i politikave, sigurimi i buxhetit nga MFPT. Rreth 3,000 familje me 14, 100 anëtarë të familjes kanë përfituar te drejtën ne Skemën e Ndihmave Sociale nga komunitetet Rome, ashkali, egjiptian për vitin 2022. Rreth 3,000 familje nga komunitetet rom, ashkali egjiptian kanë përfituar subvencione energjetike për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike.

MFPT/DPSF dhe QPS për familjet që janë përfituese të Skemës së Ndihmës Sociale dhe familjet tjera që i plotësojnë kriteret e parapara me Udhëzim administrativ për ndihme të njehershme, e realizojnë këtë ndihme financiare në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë ceremonitë e varrimit për anëtarët e familjes, dëmtimi i shtëpisë së shkatëruar nga zjarri, tërmeti ose përmytje. Ku shumica e përfitimit është nga 100 Euro deri në 300 euro sipas kësaj skeme dhe jepet vetëm një herë në vit për të njëjtën nevojë/kërkesë. Gjithsej 39 familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar nga kjo Skemë gjatë vitit 2022

Profesionistët e shërbimeve sociale, organizojnë tryeza multidisiplinare dhe bashkëpunojnë me shkollat, policinë, gjykatat. Prokurorinë, qendrat e shëndetit mendor, shërbimin sprovues, familjet për bashkim familjare. Qëllimi i takimeve është mbrojtja e interesit më të mirë të fëmijëve dhe të rriturve që bie në mandatin e tyre. Mbrojtja e interesave të fëmijëve dhe të rriturve nga Organi i kujdestarisë në QPS që ka për mandat mbrojtjen e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Rekomandimet për sektorin e punësimit

- Krijimi i bashkëpunimit me të mirë më shoqëri civile dhe donatorët për mbështetjen në organizimin e fushatave informuese të komuniteteve për dobishmërinë që sjellin aktivizimi dhe pjesëmarrja në programet e aftësisimit profesional.
- Më shumë përpjekje dhe një bashkëpunim më i madh për të shtuar pjesëmarrjen e komunitetit në MATP, shërbimet e punësimit dhe programet e trajnimit.
- Përpjekje të metutjeshme për përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucionet publike dhe ndërmarrjet që është një kërkesë ligjore me kuota të përcaktuara për komunitetet.

6.1.3 Shëndetësia

Objektivi strategjik 3 Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore.

Objektivi specifik 3.1 Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali.

MSH ka vendosur prioritetet përmirësimin i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali në Strategjinë dhe planin e veprimit. Prioritetet janë vendosur në bazë monitorimit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit paraprak.

Numri i ulët i vaksinimit nga pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali ka bërë që një pjesë e Strategjisë t'i kushtohet edukimit dhe vetëdijesimit. Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar përmirësimin të qasjes në shërbime shëndetësore, sidomos për qëllime preventive në sëmundjekronike jo të transmetueshme nga të cilat vuajnë një masë signifikante pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas QKMF në komunat Podujeve, Viti, Pejë, Gjilan duke krahasuar vetëdijesimin dhe gjendjen shëndetësore në krahasimin me vitet tjera rezultatet janë shumë më të mira dhe ka kujdes të shtuar.

Sipas të dhënave që kanë ofrua QKMF ka pasur një rritje të ndërgjegjësimit për shëndetin riprodhues dhe ekzaminime të mamografisë celulare bërjes së monografisë nga gratë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ministria e Shëndetësisë në përkrahje të OSBE-së organizuan bashkërisht seanca të shëndetit riprodhues dhe sigurimin e skanimeve të mamografisë celulare për gratë dhe vajzat e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe boshnjak 14 -22 Nëntor dhe 12-14 Dhjetor 2022 në 5 Komuna (Prizren, Mitrovicë, Gjakova, Peja, Prishtinë dhe Ferizaj), në 11 lokacione Brekoc- 32 pjesëmarrës, Ali Ibra- 43, Peja/pec 7 Shtatori- 42, Salahanne- 46, Dubrava - 40, Gjilan - 40, Prizren - 36, Prizren Bosnja Mahalla - 18, Priluzje - 23, Roma Mahalla Mitrovicë/A - 40, FKP/PR - 30). Për shkak të interesit më të lartë, mamografia u kthye dy ditë në Prizren dhe 1 ditë në Ferizaj midis 12 dhe 14 Dhjetor 2022.

Totali i 390 gra nga komunitete jo me shumicë në Kosovë kanë marr pjesë në këto aktivitete; ekzaminimeve të rregullta të mamografisë, parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, shtatzënitë e shëndetshme, lindjet dhe menopauzën e shëndetshme. 116 gra morën falas mamografi me rezultate dhe rekomandime të hollësishme nga specialisti i radiologjisë. 10 gra hynë në mamografi, por u refuzuan për arsye shëndetësore. Sondazhi i kryer para secilës seance shëndetësore demonstroi se 78% e grave pjesëmarrëse nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë nuk kanë pasur kurrë një skanim të gjirit të gjirit. Pothuajse gjysma e grave që morën pjesë, 46% nuk kishin ekzaminime të rregullta gjinekologjike.

Gjinekologu i kualifikuar prezantoi seanca të shëndetit riprodhues, ku morën pjesë 390 gra dhe vajza që i përkasin komuniteteve roma, ashkali, egjiptian dhe boshnjak. Janë shpërndarë 400

komplete që përmbajnë një muaj me vlerë furnizimin e sendeve higjienike për familjen, të cilat do të zvogëlojnë nivelin e varfërisë higjienike të familjeve të marginalizuara dhe të cenueshme. Ministrisë së Shëndetësisë siguroi mamografinë mobile dhe me staf mjekësor dhe teknik nga detyrat e tyre; Katër mjeket dhe teknik nga stafi e MSH të mamografisë - gjinekolog, teknik radiologjie, inxhinier mamografie kanë qene prezent në të gjithë 11 vendet të Kosovës dhe tre lokacione shtesë. Për më tepër, radiologu ka ekzaminuar menjëherë rezultatet e mamografisë dhe hartimin e mendimit për ekzaminimet e mundshme të mëtejshme mjekësore në lidhje me parandalimin e kancerit të gjirit.

Objektivi kryesor u arrit me sukses sepse aktiviteti adresoi mungesën e seancave të disponueshme të ndërgjegjësimit të shëndetit riprodhues dhe siguroi falas mamografi celular për gratë që po përballen me pengesa të shumta në qasjen në mamografi. Kjo u demonstrua nga sondazhi i cili tregoi një pjesë të madhe të grave që nuk shkojnë rregullisht për ekzaminime mjekësore të shëndetit riprodhues.

Divizioni për kujdesin parësorë në MSh ka raportua se gjatë vitit 2022 në kuadër të programit të vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë 1538 fëmijë, ndërsa gra shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë vizituar për herë të parë 206 gra.

Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme janë realizuar nga QKMF. Numri i fëmijëve nga 0-3 vjeç të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilëve u është ofruar vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë sipas QKMF janë si në vijim:

Ferizaj 49 fëmijë, ndërsa i grave shtatzënë 1.

Obiliq -926 fëmijë të komunitetit Rom dhe Ashkali

Prizren -113 nëna dhe fëmijë te komunitetit në fjale.

Podujeve -123 vizita dhe shërbime

Rahovec - 500 vizita.

Pejë- 19 vizita

Gjakovë - 429 vizita shtëpiake

Viti- 2 familje

Mitrovicë- 19 fëmijë dhe 10 nëna shtatzëna janë vizituar.

Objektivi specifik 3.2 Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të rëndësisë së vaksinimit dhe parandalimit të sëmundjeve kronike jo të transmetueshme.

Ndërgjegjësimi dhe promovimi e rëndësisë së vaksinimit dhe parandalimit të sëmundjeve kronike jo të transmetueshme kanë një rol të veçantë për përmirësimin e shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. MSH ka përcaktuar tri proritete për përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali si në vijim;

- 1) Pajisja me dokumente të identifikimit të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali do të lejojë qasje të gjithë pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në shërbime publike shëndetësore;
- 2) Ndërgjegjësimin e komuniteteve të synuara mbi rëndësinë e vaksinimit (sidomos pas pandemisë COVID-19), si dhe promovimin e ushqyeshmërisë së shëndetshme dhe metodat për parandalimin e sëmundjeve kronike jo të transmetueshme shëndeti i komuniteteve rom dhe ashkali do të përmirësohet në afat të gjatë;
- 3) Përmes ndërgjegjësit të stafit shëndetësor publik të të gjitha niveleve për luftimin e trajtimit të barabartë të këtyre komuniteteve me shërbime të cilësisë së barabartë dhe zbatimimi i një kodi të etikës që përmend qartazi këto principe dhe mosrespektimi i tyre rezulton në masa disiplinore, komunitetet e synuara do të marrin trajtim cilësor dhe të barabartë shëndetësor.

Me ndërgjegjësimin dhe nxitjen e familjeve të komuniteteve të rom dhe ashkali synuara mbi rëndësinë e vaksinimit janë realizuar ligjërata, takime dhe trajnime të ndryshme.

Të dhënat e QKMF në komuna janë si në vijim:

Ferizaj - Janë mbajtur ligjërata ndërgjegjësuere për kacerin e gjirit dhe IST nëpër shkolla, ku ka e nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe me gratë e komuniteteve në fshatin Dubravë. 4 ligjërata me grupe të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe organizimi i tre ekipeve mobile për vaksinimin në dy lagjet e qytetit të banuara me qytetarët e komunitetit rom ashkali dhe egjiptase në f.sh. Dubravë.

Obiliq- Janë realizuar ligjërata në komunitetet me temën „ Rritja e qasjes, mbulueshmëris dhe kërkesave për programin e vaksinimit të rregullt “. Janë mbajtur 5 (pesë) ligjërata ndërgjegjësuere në komunitet një fushatë dhe një kampanja vetëdijësuere. Obiliqi në këtë ligjëratë ka përfshi 268 pjesëmarrës.

Vaksinimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian se bashku QKMF - Obiliq me përkrahjen e Ballkan Sunflowers dhe UNICEF. Në ligjërata kanë marrë pjesë 16 veta ndërsa vaksinimi i ka përfshi 56 fëmijë i ka vaksinuar. Janë vaksinuar gjithsej 116 fëmijë me vaksina të rregullta për fëmijë; 1876 persona në total me vaksinën COVID 19 dhe 952 persona në total me vaksinën kundër gripit.

Fushë Kosovë - Është mbajtur një ligjëratë lidhur me vaksinimin e rregullte të fëmijëve. Është mbajtur një ligjëratë lidhur me vaksinimin kundër COVID 19 dhe një ligjëratë lidhur me ushqimin me qumësht të gjirit. Janë mbajtur 10 fushata të vaksinimit në komunitet, prej tyre tri derë me derë dhe 7 fushata në qendrën e komunitetit „ Fidan Lahu“. Fushatat në qendër është përcjellë edhe me ligjërata për rëndësinë e vaksinimit.

Rahovec - Janë angazhuar ekipet mobile të vaksinimit, 4 familje kanë pranua me i vaksinua fëmijët. Gjatë shënimit të ditëve të caktuar janë mbajtur rreth 20 ligjërata dhe aktivitete. Janë përfshi mbi 200 persona që kanë marrë pjesë në këto aktivitete.

Takimet mes institucioneve shëndetësore në nivel lokal dhe qendror dhe me shoqërinë civile dhe donatore që merren me aktivitete shëndetësore kanë rëndësi të veçantë për koordinimin e aktiviteteve shëndetësore.

Prizren - Janë mbajtur 2 takime nga shefi i vaksinimit në komunitet. Janë mbajtur 3 ligjërata ndërgjegjësesuese për promovimin shëndetësorë dhe parandalimin e sëmundjeve kronike. Janë vaksinuar kundër COVID 19 gjithsej 286 persona. Me vakcina të gripit 63 persona të komunitet në fjalë. Fëmijë të moshës nga 0-11 muaj 236 persona nga komunitet. Prej 12-29 mujë 56 persona nga komuniteti mbi 23 mujë 28 persona nga komuniteti në fjalë.

Gjilan - Janë realizuar nga ekipi i vaksinimit 3 takime mbi rëndësinë e vaksinimit të rregullat të fëmijëve Janë mbajtur ligjërata vetëdijesuese për parandalim dhe prevenim të sëmundjeve ngjitëse dhe ushqyeshmeris nga grupi i edukimit. Janë vaksinuar gjithsejtë 15 fëmijë me vakcine të rregullta nga ekipi i vaksinimit dhe është berë shpërndarja e fletushkave mbi organizmin e vaksinimit.

Pejë -Janë realizuar tri ligjërata ndërgjegjesuese për promovimin shëndetësore dhe parandalimin e sëmundjeve kronike. Në bashkëpunim me OJQ Mundësia 14 shtator 2022 është mbajtur karvani/fushata shëndetësore "Përshëndetje" në komunën e Pejës, në sheshin e qytetit, ku janë ofruar informata të rëndësishme mbi shëndetin sikurse janë :1. Prezantimi i faktorëve të rrezikut të SJN-ve dhe Fushatës "Për Shëndetë", 2. Rreziqet e dietës ushqimore dhe parandalimi i këtyre rreziqeve, 3. Ekspozimi ndaj tymit të duhanit, 4. Konsumimi i alkoolit, 5. Aktiviteti i pamjaftueshëm fizik.

Në bashkëpunim me OJQ-të si Pema dhe OJQ Syri i vizionit janë realizuar fushata vetëdijesuese në komunitet për Sëmundjet kronike Jo ngjitëse në Lagjen & shtatori, Cige Brestovike dhe Vitomericë, në Treboviq/Qungur ekipet e vaksinimit kanë realizuar tryeza me komunitet më qëllim të vetedijesimit për vaksinim.

Janë vaksinuar me COVID 19 gjithsej 119 persona. Të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal gjithsej 63 persona nga komunitetet rom dhe ashkali. Fëmijë të moshës 0-11 muaj 19 fëmijë, kurse prej moshës 12-59 muaj 41 persona dhe mbi 23 muaj 53 persona.

Gjakovë - Puna e vazhdueshme në teren e ekipe se vaksinimit, ligjëratat vetedijesuese në partneritet me OJQ. Janë mbajtur 13 sesione nga 20 participant për HTA, Diabet, Asma Bronchiale. Është mbajt tryeza me 10 persona, ligjërata për planifikimin familjar, kancer të qafës së mitrës. Është berë sensibilizimi i grave për luftën kundër kancerit të gjirit, rritja e vetëdijesimit për vetëkontroll dhe skrening të gjirit me kohë përmes takimeve në komunitet gjatë muajit tetor 2022, prezantimi i ligjëratës, shpërndarja e broshurave dhe caktimi i terminit për mamografi dhe PAP test.

Mitrovicë -Janë mbajtur 5 aktivitete për vetëdijesimin dhe rëndësinë e vaksinimit. Janë realizuar ligjëratë vetëdisuese për Kancer të gjirit, diabet dhe HTA. Në bashkëpunim me OJQ AMC Action for mother and children skreningu me PAP test në QMFV, ku gratë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë realizuar PAP test falas. Janë shpërndare pako ushqimore nga UNICEF-I

lidhur me vetëdijesimin e popullatës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për t'ju përgjigjur vaksinimit.

Trajnimet kanë vazhduar edhe në tema si; për pasojat e martesave dhe lindjeve të hershme, planifikimi familjar dhe IST, menopauza, kanceri ne mitër/qafë të mitrës. Për të ngritur vetëdijesimin janë organizuar fushata, trajnim edhe tryeza për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali nga QKMF në komunat.

Ndërgjegjësimi për promovim shëndetësorë dhe parandalimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse, ushqyeshmëria për komunitetet rom dhe ashkali është ndër prioritetet e caktuar nga MSH. Për të arritur këtë objektivë janë organizuar ligjërata ndërgjegjësuese për promovim shëndetësorë dhe parandalimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse, ushqyeshmëri si në vijim;

Podujevë - Është një përmirësim dhe vetëdijesimi sa i përket rëndësisë për shëndetë; janë shpërndarë fletushka informuese 39 për kundër COVID 19, për mobilizim për vaksinimin ku dhe janë shpërndare 40 fletushka. Janë realizuar 87 vaksina për fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe 4 vaksina për gripin së zonalë.

Divizioni për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor (DDQKSH) ka bashkëpunuar dhe ka pasur takime me organizata që merren komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe me projektin e Kujdesi Shëndetësorë i Qasshëm dhe Cilësor (Accessible Quality Healthcare-AQH), ku janë realizuar tri ligjërata me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në tri Komuna.

IKSHPK -Realizimi i punëtorive dy ditore në katër komunat me profesionistët shëndetësor të KPSH: Fushë Kosovë, Lipjan, Gjilan dhe Gjakovë, në lidhje me planin e aktiviteteve edukativo-shëndetësore në komunat gjegjëse. Me theks të veçantë puna me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas raportit të IKSHPK janë realizuar trajnimet me profesionistet shëndetësorë për "Viziat Shtëpiake", përshirë modulën e rëndësisë së vaksinimit. Janë realizuar gjithsej 143 sesione të vaksinimit mobil në 16 komuna për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

IKSHPK ka bere identifikimin i fëmijëve të pa vaksinuar nga komunitet rom, ashkali dhe egjiptian përmes vizitave "derë me derë". Përmes kampanjës "derë më derë" janë vizituar 9,149 fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Janë identifikuar si të pa vaksinuar 2,548 fëmijë (48% vajza), të cilët janë vaksinuar përmes kampanjës së vaksinimit mobil "catch-up vaccination". 458 fëmijë janë vaksinuar me vaksinën MMR.

IKSHPK ka realizua dy trajnime me përfaqësues të komuniteteve rreth vaksinimit të rregullt dhe vaksinimit kundër COVID-19.

IKSHPK ka realizuar ligjërata dhe sesione informuese me prindër nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me rëndësinë e vaksinimit, rëndësinë e gji dhënies si dhe kontrolleve rutinë.

IKSHPK -Përfaqësuesit e trajnuar të komunitete shkojnë shtëpi me shtëpi në kuadër të fushatës për vaksinim.

IKSHPK-Gjithsej janë realizuar 24 sesione informuese/ligjërata me prindër dhe kujdestarë ligjorë në 16 komuna lidhur me rëndësinë e vaksinimit, si dhe për ushqyeshmerinë dhe kontrollet rutinë.

Mbi 650 prindër kanë marrë pjesë në këto sesione, të facilituar nga mjekë familjarë nga Kujdesi Parësor Shëndetësor. Janë realizuar gjithsej 143 sesione mobile të vaksinimit për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian.

Objektivi specifik 3.3 Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimi të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe cilësor të komuniteteve Rom dhe Ashkali, për t'u siguruar se personat që iu përkasin komuniteteve kanë qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor pa diskriminim.

Këshilli i Pacientëve është një mekanizëm formal i QKMF - së për të dëgjuar zërin e pacientëve i paraparë edhe me statutin e këtij institucioni. Themelimi i këtij Këshilli ka për qëllim që kujdesi shëndetësor me pacientin në qendër, në bazë të reflektimit vështirësitë, brengat dhe interesat e pacientëve të marrin një formë, të jenë pikë orientuese e dizajnit dhe shpërndarjes së kujdesit shëndetësor për qytetarët.

Ky Këshill do i ndihmon edhe për përmirësimin e shpërndarjes e kujdesit shëndetësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali. Themelimi i Këshillit është proces i ri dhe në shumicën e komunave ende nuk është themeluar. Komuna e Rahovecit ka krijuar Këshillin i pacientëve në dhjetor 2022, kurse në komunën e Gjakovës ekziston zyra për komunitet, ku një përfaqësues i tyre merr pjesë në takime të ndryshme, ku dhe mbron interesat e komunitetit apo dërgohen informacione përmes këtij përfaqësuesi.

Ofrimi i trajnimit për stafin profesionist shëndetësor për mos diskriminim në ofrimin e shërbimeve mjekësore. (20 komuna).

Gjatë viti 2022 Divizioni për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor me projektin e Kujdesi Shëndetësorë i Qasshëm dhe Cilësor (Accessible Quality Healthcare-AQH) ka organizuar 5 (pesë) tryeza prezantimi dhe diskutimi për ligjin për mbrojtje nga diskriminimi në QKMF Komunale si : Malisheve; Rahovec; Kamenicë; Klinë; Llapjanë.

Tryezat i kanë përfshi shefat e njësive kanë pasur për qëllim të njoftojnë stafin shëndetësorë në nivelin udhëheqës lidhur me të drejtat në baze të këtij ligji gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore. Tryezat e mbajtura nga DDQKSH -MSh kanë përfshi gjithsej 62 pjesëmarrës.

Prizren- Është mbajtur trajnimi për protokollin shtetërorë për trajnimin për trajtimin të rasteve të dhunës seksuale protokollin i cili është lansuar me 5 dhjetor në 2022 nga Ministria Drejtësisë në bashkëpunim me Institutin e mjekësisë ligjore.

Pejë - Trajnime për protokollin shtetërorë për trajtimin të rasteve të dhunës seksuale, protokollin i cili është lansuar me 5 dhjetor 2022 nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Në bashkëpunim me OJQ - Prak, OJQ Balkan sunflowers janë realizuar trajnime me menaxhmentin lidhur me fushatën vetëdijesuese për vaksinim. Pjesëmarrësit në trajnim ishin stafi i shefave të njësive dhe infermierëve lidhur me të drejtat e pacienteve. Kurse me projektin e Kujdesi Shëndetësorë i Qasshëm dhe Cilësor është organizuar trajnimi e stafit për mekanizmin e ankesave dhe prezantimin e fletëvotimit kom unitarë, takimet me komunitetin lidhur me procesin e punës dhe shërbimeve që ofrohen në QKMF.

Vetëdijesuese për të drejtat e pacientit dhe mekanizmave përgjegjës për ankesa të komuniteteve rom dhe ashkali drejtuar punëtorëve shëndetësor dhe pjesëtarëve të komuniteteve është kurcial për mbrojtjen e të drejtave dhe pranimin e shërbimeve me cilësorë.

MSH - Divizioni për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor me përkrahjen e projektit të AQH-së ka organizuar tri tryeza diskutimi me përfaqësuesit e OJQ -ve të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian dhe një numër të qytetareve të këtij komuniteti ku është prezantua para tyre ligji për mbrojtje nga diskriminimi dhe e drejta për të berë ankesë në linjën e ankesave në MSh për pakënaqësitë lidhur me shërbimet shëndetësorë.

Podujeve- Është mbajtur takime edukimi me ekipet mjekësorë në vendbanimet ku jetojnë komuniteti lidhur me temat vetëdijesimi për të drejtat e pacientit dhe ankesat nga komuniteti në fjalë, ku janë përfshi gjithsej 30 persona nga OJQ dhe qytetarë të komuniteteve.

Gjilan- Është berë nga grupi i edukimit një fushate vetëdijesuese mbi të drejtat e pacienteve.

Mitrovicë - Është mbajtur ligjërata për vetëdijesim për drejtat e pacientit.

Sfidat për sektorin e Shëndetësisë

- Mbulimi i ulët i sigurimeve shëndetësore në Kosovë shpjegohet me faktin se në Kosovë, ndryshen ga vendet e tjera, nuk ka sigurim shëndetësor të detyrueshëm,
- Pagesat informale/participimi i komunitetit, janë një pengesë tjetër për përfitimin e shërbimeve.
- Varfëria dhe mungesa e të ardhurave është pengesë edhe për blerjen e medikamenteve dhe trajtimin e sëmundjeve.

Rekomandimet për sektorin e Shëndetësisë

- Fushata të ndërgjegjësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për kujdesin parandalues por edhe përmirësimit të shëndetit të tyre, duke rritur aksesin në shërbime shëndetësore, aty ku ata jetojnë.
- Organizimi i Karavaneve të shëndetit në komunitet.
- Vizitat në shtëpi është një program i Ministrisë së Shëndetësisë i cili synon të përmirësojë rezultatet e shëndetit të nënës dhe fëmijës duke sjellë shërbimet kryesore më pranë familjeveme ndihmën e UNICEF-it dhe mbështetjen bujare të Qeverisë së Luksemburgut, programi tani është plotësisht i integruar në shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor të

fuqizohen mekanizmat që ky shërbim të jete me i qasëshem për komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

- Shumë pjesëtar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian - sidomos në disa komunitete shumë të varfra, të izoluar dhe me nivel shumë të ulët arsimor - nuk e përdorin shërbimin shëndetësor, sepse nuk janë të vëditësuar sa duhet se gjendja e tyre shëndetësore kërkon trajtim mjekësor. Në këtë rast politikat shëndetësore duhet të synojnë edukimin dhe vetëdijesimin e këtyre grupeve lidhur me kushtet bazë shëndetësore. Ky edukim mund të bëhet në shkollë, në qendra shëndetësore ose nëpërmjet personelit shëndetësor që duhet t'i vizitojë këto komunitete në mënyrë periodike. Ky edukim shëndetësor, edhe sipas përvojës së vendeve të tjera duhet bërë me një gjuhë të thjeshtë dhe në përputhje me kulturën dhe nivelin arsimor të këtyre komuniteteve. Kjo ka si parakusht trajnimin paraprak të ekipeve shëndetësore me veçoritë (kushtet dhe mënyrën e tyre të jetesës, kulturën e tyre, mobilitetin, etj) e komuniteteve Rom ashkali dhe egjiptian.
- Qendrat shëndetësore pranë komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duhet të nxisin planifikimin familjar nëpërmjet trajnimeve, informimit dhe shpërndarjes falas të mjeteve moderne kontraceptive.

6.1.4 Banimi

Objektivi strategjik 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet Rom dhe Ashkali.

Sipas ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit, Komunitat kanë përgjegjësit të hartojnë për periudhën 3 vjeçare në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet që janë në Komunë.

Për vitin që po raportojmë Programet trevjeçare të banimit janë të paraqitura në mënyrë tabelorë në Excel (komunitat të cilat kanë programet me afat, të skaduar, drafte dhe komunitat të cilat nuk kanë hartuar).

Përmbledhje e Programeve trevjeçare të banimit në Komunitat në Republikën e Kosovës
13 Komunitat kanë të hartuar me afat kohor Programin trevjeçare të banimit
10 Komunitat kanë të skaduar Programin trevjeçare të banimit
5 Komunitat kanë të draftuar (pritje) Programin trevjeçare të banimit
10 Komunitat nuk kanë të hartuar Programin trevjeçare të banimit komunitat

Për zbatimin e tyre sipas Ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit duhet të raportohet në çdo 31 mars të vitit vijues mirëpo shumë pak komuna raportojnë për implementimin e projekteve në kuadër të programeve trevjeçare të banimit.

Gjendja e programeve trevjeçare të banimit në komunat e Republikës së Kosovës 24.01.2023				
Nr.	Me afat kohor	Të skaduar	Draft	Nuk e kanë të hartuar
1	Deçan	Ferizaj	Gjilan	Dragash
2	Fushë Kosovë	Glogoc	Novobërdë	Junik
3	Gjakova	Hani i Elezit	Suharekë	Kllokot
4	Graçanica	Kamenicë	Viti	Leposaviq
5	Istog	Malishevë	Ranillug	Mamush
6	Kaçanik	Pejë		Mitrovicë e Veriut
7	Klinë	Prizren		Partesh
8	Lipjan	Shtërpçë		Prishtinë
9	Rahovec	Vushtrri		Zubin Potok
10	Skenderaj	Shtime		Zveçan
11	Obiliq			
12	Mitrovicë e Jugut			
13	Podujevë			

Objektivi specifik 4.1 Sigurimi i Qëndrueshmërisë dhe Përcaktimi i hapave konkret për të përmirësuar sistematikisht gjendjen e banimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmes studimit të fizibilitetit për banim të qëndrueshëm dhe banim social për komunitetet Rom dhe Ashkali.

Në planin legjislativ është paraparë hartimi i projektligjit për banim social. Gjatë vitit 2022 Grupi Punues Ndërministror ka vazhduar hartimin e projektligjit për Banim Social.

Konsultimet me publikun janë mbajtur në periudhën 26.07-16.08.2022, ku janë pranuar komentet nga 13 Institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Në platformës online të MMPHI-së është publikuar procesi i konsultimit për projektligjin për banim social me datën 17.10.2022.

Pas konsultimit publik, është paraqitur kërkesa për të plotësuar projektligjin edhe me disa programe shtesë për realizimin e Programit të Banimit Adekuat Social në Kosovë në bashkëpunim CEB-bankën (duke i marr rekomandimet nga Studim Fizibiliteti) dhe rishikimin e mundësisë për kërkesën e IFC për të plotësuar aspektin ligjor për banim të përbalueshëm.

Objektivi specifik 4.2 Vetëdijësi dhe ndërgjegjësi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në zgjidhjen e problemeve të banimit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues (MMPHI) në bashkëpunim me UN-Habitatin dhe me Institucionet tjera ndërkombëtare është hartuar dhe aprovuar Studim Fizibiliteti për Programin e Banim Social Adekuat (shkurt 2022). Studim Fizibiliteti për Programin e Banim Social Adekuat është përkrahur nga CEB-Banka.

Nga CEB-Banka është aprovuar kërkesa për kredi me interes të ulët prej 25.0 mil euro për bashkëfinancimin e Projektit të Banimit Adekuat Social. Në vitin 2023 pritet të bëhet ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nga WBIF është fituar Grantin për Asistencë Teknike prej 2.08 milion Euro. Ku grant do të shfrytëzohet për përgatitjen e investimeve në Vlerë prej 47.5 mil euro.

Janë mbajtur trajnime për zyrtarët komunal për funksionalizimin e platformës elektronike - data baza e banimit social. Ky trajnim është përkrahun nga RCC.

Objektivi specifik 4.3 Ngritja e komoditetit dhe cilësisë së jetës së komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese si dhe infrastrukturës përcjellëse për qasje më të mirë në shërbime esenciale.

Ministria e Kthimit dhe Komunitete ka ofruar ndihme për komunitetin rom dhe ashkali si; ndërtimi i shtëpive për të kthyerit (Romë, Ashkali), mobilje dhe teknika të bardha për të kthyerit (Romë, Ashkali), mobilje dhe teknika të bardha për komunitetet pakicë (Romë, Ashkali), ushqim dhe higjiena (Romë, Ashkali), dru zjarri (romë, ashkali), grant ekonomik për hapjen e një biznesi familjar (rome, ashkali). Qëllim I ndihmave ishte përmirësimin e kushteve të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022. Ky raport pasqyron përkushtimin e MKK-së për përmirësimin e pozitës së komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare.

	Lloji i asistencës	Shuma	Çmimi	Totali
1.	Ndërtimi i shtëpive për të kthyerit (Romë, Ashkali)	4		70.721,35€
2.	Mobilje dhe teknika të bardha për të kthyerit (Romë, Ashkali)	4	2.600,00€	10.400,00€
3.	Mobilje dhe teknika të bardha për komunitetet pakicë (Romë, Ashkali)	1	966,75€	966,75€
4.	Ushqimi dhe higjiena (Romë, Ashkali)	4	750,00€	3.000,00€
5.	Dru zjarri (romë, ashkali)	4	325,00€	1.300,00€
6.	Grant ekonomik për hapjen e një biznesi familjar (rome, ashkali) -IG	4		8.214,67€
7.	Subvencione për festimin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve	1	3.200,00€	3.200,00€
8.	Pako për Vitin e Ri për fëmijë (Romë, Ashkali)	100	9,90€	990,00€
Në total:				98.792,77€

Sipas të dhënave nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve në kuader të Ministrise Punëve të Brendshme personat të riadhesuar nga komunitetet rom ashkali dhe egjiptian në arritjen në Kosovë siguruar ndihma dhe mbështetje në skemat për Riintegrim në transport deri në komunën e origjinës, Akomodimi i përkohshëm (7 ditor) në Qendrën e Akomodimit dhe ushqim i përgatitur (servuar), Pako ushqimore dhe higjienike dhe materiale (me një e më shumë furnizime), Akomodim me qera deri ne 12 muaj (6 deri 12 muaj shfrytëzimi), Pakoja e ndihmës për dimër (dru për ngrohje), Vetëpunësim (financimi i biznesit), Trajnim në Punë. Nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë perfituar gjithsej 354 ; Rom 135, Ashkali 177, Egjiptin 42.

Një kontribute tjetër gjatë vitit 2022 është dhënë nga Zyra e Kryeministrit, për zgjidhjen e situates për familjet rom të kthyer nga Maqedonia e Veriut që janë pa strehim, ku këshilltarja e Kryeministrit ka qenë aktive në ngritjen e çështjes më donatoret dhe institucionet përkatës në rreth 10 takime dhe 2 vizita në terren dhe zgjidhje të përkohshme është gjetë në bashkëpunim me aktere të tjera, mirëpo duke punuar të vazhdimisht për gjetjen e zgjidhjes së përhershme.

Të dhënat për ndihma dhe mbështetje në skemat për Riintegrim sipas Përkatësisë Etnike (për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) për vitin 2022 me të detajuar mund të shihni në tabelën në vijim.

NDIHMJA DHE MBËSHTETJA NË SKEMAT PËR RIINTEGRIM SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE (PËR KOMUNITETET ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIAN) PËR VITIN 2022

Sqarim: Një vendim i aprovuar nga organet vendimmarrës i një personi apo familje të ripranuar (riadhesuar) mund të jetë përftues i dy e më shumë skemave për Riintegrim.

Nr	Shërbimet e ofruara nga Buxheti i Riintegrimit, Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare që mbështesin procesin e riintegrimit		Përkatësia Etnike						
			Romë	Kosto mesatare e shpenzimeve	Ashkali	Kosto mesatare e shpenzimeve	Egjiptian	Kosto mesatare e shpenzimeve	Nuk kanë deklaruar përkatësin etnike
1	Transport deri në komunën e origjinës	persona	19	484.5 €	32	816 €	2	51 €	6
2	Akomodimi i përkohshëm (7 ditor) në Qendrën e Akomodimit dhe ushqim i përgatitur (servuar)	persona	7	661.5 €	8	756 €	/	/	/
3	Pako ushqimore dhe higjienike dhe materiale (me një e më shumë furnizime)	persona	39	2,983.5 €	33	2,524.5 €	2	1 53 €	95
4	Akomodim me qera deri ne 12 muaj deri 12 muaj shfrytëzimi) (6	persona	56	36,472.8€	59	38,426.7 €	30	19,539 €	22
5	Pakoja e ndihmës për dimër (dru për ngrohje)	familje	10	2,336 €	6	1,401.6 €	3	700.8 €	2
6	Vetëpunësim (financimi i biznesit)	persona	4	12,000 €	36	108,000 €	5	15,000 €	384

7	Trajnim në Punë	persona	/	/	3	1,530 €	/	/	285
---	-----------------	---------	---	---	---	---------	---	---	-----

Sqarim: **Kolona nuk kanë deklaruar përkatësin etnike**, pasqyron të dhënat e pranuar statistikore nga institucionet vendore dhe organizatave ndërkombëtare të cilat të dhëna janë pranuar pa specifika përcjellëse, (përkatësin etnike) dhe në kolonën e cekur mund të ketë persona përfitues edhe të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Rekomandimet për sektorit e Banimit

Nga Studim Fizibiliteti kanë dal këto rekomandime:

- Ka një mungesë të dukshme të efektivitetit dhe koordinimit nga autoritetet kombëtare/lokal, gjë që i lë përfituesit të pa informuar për mundësitë e banimit social dhe pa mbështetjen e duhur.
- Ndërtesat e Banimit Social aktuale janë në gjendje jo të mirë dhe kanë nevojë urgjente për renovime. Monitorimi dhe mirëmbajtje e rregullt pothuajse nuk ekziston, me ndarje të paqartë të përgjegjësi, të stafit dhe buxheteve të alokuara.
- Programet tre vjeçare të banimit nuk përgaditen rregullisht nga komunat dhe nuk raportohen nga MMPHI-ja. Secila komunë duhet të caktoj të paktën një zyrtar që do të merret me të gjitha nevojat dhe aplikimet për banim social.
- Ka nevojë për një system më të mirë të menaxhimit të të dhënave në nivel local për të mbledhur, mirëmbajtur dhe analizuar të dhënat e aplikantëve për banim, dhe për të përmbushur më mirë kërkesat e tyre.
- Nevojitet më shumë financime në këtë sector, mbështetut nga plane dhe programe të qarta zhvillimi. 95% e komunave theksuan financat si pengesën më të madhe për funksionimin apo zhvillim e sektorit të banimit social.

6.1.5 Diskriminimi

Objektivi strategjik 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimit, stereotipeve dhe bullizmit

Objektivi specifik 5.1: Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve

Qeveria e Kosovës ka vazhduar me aktivitetet për luftimin e diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve.

Për të luftuar diskriminimin dhe për të siguruar një qasje për të gjithë barabartë në Drejtësi Akademia e Drejtësisë ka organizuar trajnime të vazhdueshme profesionale për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, për avokat shtetëror, avokatë, noterë, përmbanues privat, ndërmjetësues, administratorët

Akademia e Drejtësisë nga programi trajnues që ka në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në vitin 2022, 4 prej tyre kanë qenë me theks në luftimin e diskriminimit dhe racizmit.

Në vijim detajet sa i përket tematikës dhe pjesëmarrjes së trajnimeve ishin:

1. Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik”.
2. Trajnim për qasje në drejtësi për grupet e cenueshme-penale”.
3. Trajnim për qasje në drejtësi për grupet e cenueshme-civile”.
4. Aspekti material dhe procedural i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi i Republikës së Kosovës dhe sfidat në zbatimin e tij si dhe raporti i tij me ligjet tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore.

Këto aktivitete trajnuese kishin në fokus trajtimin e kornizës ligjore vendore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë, të drejtave dhe qasjen e barabartë në tregun e punës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Vëmendje të veçantë kishin stereotipet, paragjykimet dhe llojet e përkatësisë etnike të bazuar në diskriminimin.

Pjesëmarrës në trajnim I. ishin 4 gjyqtarë (3 nga niveli themelor dhe 1 nga Apeli) si dhe 5 prokuror, kryesisht të nivelit themelor.

Pjesëmarrës në trajnimin e II. ishin: 3 prokurorë si dhe 18 staf administrativ që vinin nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional si dhe zyrtarëve tjerë nga gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.

Pjesëmarrës në trajnimin e III. ishin: 2 gjyqtarë si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Ferizajit.

Pjesëmarrës në trajnimin e IV. ishin: 49 gjyqtarë (2 nga Gjykata Supreme, 19 nga Gjykata e Apelit si dhe 28 nga niveli themelor I gjykatave) si dhe 1prokuror nga Apeli dhe 1 bashkëpunëtorë profesional

Instituti i Kosovës për Administratë Publike ka organizuar kurse trajnimi për zyrtaret që punojnë në administrate me temën “Të drejtat e komuniteteve në Kosovë dhe “Hyrje në antigjipsizëm”.

- Trajnimi “Të drejtat e komuniteteve në Kosovë” trajnimit ka zgjatur 2 ditë me 1 grup të pjesëmarrësve dhe janë trajnuar 9 nëpunës civil.
- Trajnimi “Hyrje në antigjipsizëm” trajnimit ka zgjatur 2 ditë me 2 grupe të pjesëmarrësve dhe janë trajnuar 23 nëpunës civil.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike AKSP për zhvillimi i kapaciteteve për zyrtar të sigurisë publike ka afruar trajnimeve themelore, të avancuara dhe të specializuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe racizmit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Në trajnimet e organizuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike AKSP janë trajtuar temat e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe racizmit. Nga 6 tema të ligjëruara me gjithsej 597 pjesëmarrës – zyrtar të sigurisë publike.

Janë zhvilluar trajnimet themelore, të avancuara dhe të specializuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe racizmit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për Policinë e Kosovës; Shërbimin Korrektues; Shërbimin Sprovues; Doganën e Kosovës; Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; Inspektoratin Policor të Kosovës si dhe personat privat fizik dhe juridik.

Trajnimet organizuara janë trajtuar temat për parandalimin dhe luftimin e Krimeve të urrejtjes si vijon:

- Trajnimi Profesional Zyrtar Policor;
- Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues;
- Trajnimi Themelor i Hetimit të Krimit;

Emërtimi	Temat e Trajtuar	Vijues
Trajnimi Profesional Zyrtar Policor	Në modulet 1 dhe 3 janë trajtuar këto tema: Kimet e Urrejtjes , Mosdiskriminimi dhe Dinjiteti Njerzor	433
Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues	Në modulën 3 janë trajtuar këto tema: Ndalimi i tortures dhe i Keqtrajtimit	46

Trajnimi Themelor i Hetimit të Krimet	Në kuadret të këtij trajnimi janë trajtuar këto tema: Krimet e motivuara nga urrejtja, Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut etj.	118
Totali i vijuesëve të Certifikuarë		597

Objektivi specifik 5.2 Rritja e llogaridhënies dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të racizmit dhe diskriminimit përmes ndërgjegjësimit të komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë dhe mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës dhe dhunës se urrejtës dhe bullizmit.

Nga Qeveria e Kosovës janë krijuar mekanizmat për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024 dhe më shumë përkushtim për zbatimin e Deklaratës së Poznanit si ne vijim:

- 1 Grupi Punues Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- 2 Ekipi ndërinstucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
- 3 Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

1. Grupi Punues Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Qeveria e Kosovës duke marrë më shumë përkushtim për zbatimin e Deklaratës së Poznanit me Vendimin e Kryeministrit të Kosovës të datës 11.09.2020 - me nr. 138/2020 ka themeluar Grupin Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Qëllimi i krijimit të Grupit Teknik të Punës është zbatimi i përgjegjësive që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, ai ushtron kompetencat e mëposhtme:

- Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për adresimin e ankesave nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për diskriminim ndaj tyre, si dhe procedimin e këtyre rasteve tek institucionet kompetente;
- Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për të siguruar mbështetje ligjore për viktimat e supozuara dhe identifikimin e skemave të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin institucional dhe të fshehtë, bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë;

- Realizon aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut për parandalimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;

Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit ka organizuar tri takime me Grupin teknik për mbrojtje nga diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me 29.03.2022, me 05.09.2022 dhe me 15.12. 2022.

Takimet janë organizuar në pajtim me Vendimin e Kryeministrit me datë 11.09.2020- me nr. 138/2020 për Themelimin e Grupit teknik punues për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Takimet kishin për qëllim prezantimin dhe diskutimin e rasteve të paraqitura në Platformën Kombëtare kundër diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Është hartuar raporti vjetor për vitin 2022 të Grupit teknik për rastet e paraqitura në platformën kundër diskriminimit dhe rastet e trajtuara. Raporti është punuar duke u bazuar në provat e paraqitura në kuadër të platformës kombëtare dhe ndërlidhje e provave me diskriminimin eventual të palëve që kanë paraqitur rastet, në kuadër të platformës kombëtare. Trajtimi juridik i rasteve është bërë duke u bazuar në legjislacionin e aplikueshëm për mbrojtje nga diskriminimi i komunitetit, rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, në këta aspekt, është marrë parasysh edhe udhëzuesi për identifikimin e rasteve etj.

Në kuadër të metodologjisë së trajtimit të rasteve të raportuara në platformë janë marrë parasysh aspektet si në vijim:

1. Provat e paraqitura në kuadër të platformës;
2. Kualifikimi i rastit në raport me Ligjin e aplikueshëm për mbrojtje nga diskriminimi;
3. Ndërlidhja e rrethanave të rastit me provat;
4. Ndërlidhja e rrethanave të rastit me kushtetutën, ligjin e aplikueshëm si dhe praktiken ndërkombëtare të GJEDNJ-së;
5. Kualifikimi juridik, nëse ka pasur diskriminim, bazuar në fakte dhe ligjin e aplikueshëm;
6. Adresimin e shkresave, ankesave dhe padive, kudo që ka pasur nevojë;
7. Konkluzionet respektive në lidhje me rastet.

2. Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Me Vendimin e Kryeministrit nr. 6/81 të datës 01.06.2022 është themelua Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të inkurajimit, promovimit dhe koordinimit të veprimeve dhe aktiviteteve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, si të avancimit

të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe barazisë së tyre. Duhet theksuar se themelimi i Ekipit është masë e përkohshme afirmative për inkurajimin dhe avancimin si dhe për arritjen e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, siç është përcaktuar në Kushtetutë. në ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës. Themelimit të Mekanizmit i ka paraprirë një analizë e “kornizës së legjislacionit ekzistues në lidhje me punësimin e komuniteteve me theks të veçantë në punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës të kryer nga ZQM/ZKM me mbështetjen e VoRAE.

Ekipi ndihmon institucionet publike në zbatimin e obligimeve të tyre ligjore, duke përfshirë por pa u kufizuar në legjislacionin që ka të bëjë me kuotat e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe krijimin e mundësive të barabarta dhe përfaqësimit proporcional të komuniteteve në institucionet publike. Gjithashtu, Ekipi koordinon masat dhe veprimet që do të ndërmerren nga institucionet në përgatitjen e akteve nënligjore, politikave dhe udhëzimeve përkatëse në lidhje me zbatimin e kuotës së punësimit dhe për përmirësimin e pozitës së këtyre komuniteteve, duke përfshirë hartimi i Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024, bazuar në kornizën e re strategjike të BE-së për përfshirjen e komuniteteve 2020-2030. Në të njëjtën kohë, Ekipi monitoron dhe raporton për zbatimin e politikave për romët, ashkalisht dhe egjiptianët për të matur arritjen e objektivave të përcaktuara në Deklaratën e Poznanit.

Ekipi përbëhet nga përfaqësues të institucioneve relevante si dhe tre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me dhe për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, kështu që secili komunitet do të përfaqësohet nga një shoqëri civile, Komuniteti rom një, një ashkali dhe një egjiptian. Përfaqësuesit nga shoqëria civile emërohen në një proces të hapur dhe transparent, në përputhje me parimet e përcaktuara nga platforma e shoqërisë civile në Kosovë - CIVIKOS; në mënyrë që të përmirësohet përfaqësimi i këtyre komuniteteve në punësim në institucionet publike.

Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, ka mbajtur takimin e parë punues me 06 shtator, 2022, e organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit.

Ky takim është shfrytëzuar për prezantimin e përbërjes së Ekipit, si dhe për të qartësuar qëllimin dhe përgjegjësit që bien në mandatin e këtij Ekipi. Gjithashtu, gjatë këtij takimi janë vendosur prioritetet e punës së këtij Ekipi, është diskutuar për hapat që duhet ndërmarrë drejt bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse dhe aktivitetet për vetëdijësimin e publikut, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve në të ardhmen.

Gjithashtu, në datat 11-12 nëntor 2022, Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit me perkrahje të VoRAE ka organizuar një punëtori të përbashkët me anëtarët e Ekipes, institucionet dhe shoqërinë civile për shqyrtimin dhe finalizimin e dokumenteve për fuqizimin e këtij mekanizmi si më poshtë:

- Rregullat e punës së Ekipit ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës. Me këto rregulla të punës përcaktohen procedurat e brendshme të veprimit dhe funksionimit të Ekipit Ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës dhe Sekretarisë së Ekipit.
- Plani i punës i ekipit ndërinstitucional për promovimin dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës - tremujori i fundit i vitit 2022 dhe 2023. Janë definuar Detyrat dhe përgjegjësitë si dhe aktvitetet e Ekipit ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, të përcaktuar me Vendim të Qeverisë Nr.06/81 (01.06.2022).

Më datën 01 dhjetor 2022 Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit ka organizuar tryezën për Lansimin e Ekipit ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës.

Takimi ka pasur për qëllim prezantimin e Planit të punës të Ekipit ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve të Kosovës për realizimin e përgjegjësiave sipas Planit të punës.

Në mënyrë të realizimit të kuotës për punën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe të respektuar në praktikë ato, është realizua takim me Drejtorinë e Përgjithshme të ShSKUK, dhe shefet e divizionit për burimet njerëzore me 05 Korrik 2022, në këtë takim është biseduar për mënyrat e shpallura sa më gjerësisht konkurset e punësimit në kuadër të ShSKUK, dhe është pajtuar që një përfaqësues i ShSKUK-së merr pjesë në takimet e rregullta të ndërinstitucionale për nxitjen dhe punën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjithashtu, nga data 18.11.2022 deri më 02.12.2022, Ministria e Arsimit ka hapur thirrje për bursa për 100 studentë nga komuniteti ashkali, egjiptian dhe rom, fillimisht kjo thirrje ka qenë e dedikuar për Fakultetin e Edukimit, por për arsye të numër i ulët i aplikantëve, thirrja tashmë është për të gjitha lëndët në të gjitha universitetet publike. Përmes bursave dhe mekanizmave të tjerë janë fuqizuar gjeneratat e reja të edukatorëve dhe mësuesve nga radhët e komuniteteve, ku tani janë formuar kuadro të reja të gatshme për punësim.

Në tetor 2022, Kryeministri mori pjesë në një konferencë të organizuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë, me zyrtarë komunalë dhe OJQ që punojnë me komunitetet jo shumicë.

Në konferencë u prezantua platforma www.raportodiskriminimin.org, si dhe risitë në <https://ekosova.rks-gov.net>, p.sh. për aplikime për bursa dhe kopje të dokumenteve personale; informacion mbi politikën për një punësuar në çdo familje dhe një pako për përpalljen me inflacionin, si dhe mundësitë për studime Master jashtë vendit, me punësim të garantuar në qeveri dhe më pas me programin YoungCell të sponsorizuar nga Bashkimi Evropian.

3. Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ka nisur të funksionojë prej datës 1 maj, 2022, përderisa lansimi zyrtar i saj është bërë me 22 qershor, 2022.

Më 22.06.2022 u organizua një konferencë për lansimin e Platformës Kombëtare për raportimin e rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Qëllimi i platformës është të kontribuojë në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke ofruar qasje më të lehtë për qytetarët për të raportuar rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe referimin e tyre në institucionet përkatëse, për të ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse.

Është një rast unik, që një Qeveri të hapë një platformë për t'u mundësuar qytetarëve të raportojnë rastet e mundshme të diskriminimit.

Përgjatë 8 muajve të punës së vitit 2022 në Platformë janë regjistruar 306 persona dhe është vizituar nga 5.996 persona. Në të, deri më tani janë paraqitur (raportuar) 14 raste, disa nga të cilat nuk mund të cilësohen si raste konkrete rreth ndonjë rasti të raportuar, por janë vetëm tentim për të kontaktuar me administruesen e Platformës, ose për të shprehur qëndrime që nuk ndërlidhen me përgjegjësitë e Platformës. Kështu, nga 14 raste, vetëm 6 prej tyre janë raste të adresuara me ndonjë të dhënë konkrete. Tetë raste janë trajtuar nga të cilat kanë elemente të rasteve të diskriminimit, ndërsa katër të tjera cilësohen si raste në tentativë për të komunikuar me Platformën. ZQM-ZKM ka saktësuar se raportuesve u është kthyer përgjigje dhe se ata janë kontaktuar përmes të gjitha rrugëve të komunikimit. Ndërsa, rastet ku ka elemente të diskriminimit janë trajtuar institucionalisht nga ekipi profesional, i udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë-ZKM.

Të gjitha rasteve i është kthyer përgjigje, për gjashtë nga to është diskutuar dhe janë trajtuar institucionalisht nga ekipi profesional, i udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë, që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës.

Ndërkohë, gjatë vitit 2022 janë shkruar dhe publikuar në Platformë 11 lajme nga aktivitetet e ndryshme që janë organizuar nga institucionet e Kosovës, të cilat kanë punuar drejtë për së drejti në mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Me kërkesë se Zyrës për Qeverisje të Mirë, - Zyra e Kryeministrit (ZQM) e drejtuar në RTK për lansimin e një videoje për të promovuar dhe për të nxitur vetëdijësimin e popullatës mbi mundësitë e barabarta, kundër diskriminimit dhe parimet tjera të qeverisjes demokratike. Në kuadër të kësaj përmes transmetimit të videos për dy javë gjatë muajit nëntor 2022 në RTK është bërë lansimi i Platformës Nacionale për raportimin e rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Janë organizuar sesione informuese për mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës dhe dhunës së urrejtës dhe bullizmit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për zyrtarët dhe OJQ-të në nivel qendror dhe lokal gjatë muajit tetor dhe nëntor 2022, ku janë shpërndarë fletushka 500, postera 50 për qëllimin dhe përdorimin e platformës. Takimet janë organizuar në 5 regjione të Kosovës.

Publikimi i Kërkimeve Kombëtare për Antigjipsizmin në Kosovë

Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me organizatën "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve", "Terre des hommes" dhe "HEKS" ka realizuar "Hulumtimin Kombëtar për Antigjipsizmin në Kosovë". Me 19 maj 2022 me një konferencë është bërë "Publikimi i Hulumtimeve Kombëtare për Antigjipsizmin në Kosovë", ku janë prezantuar gjetjet në terren për praninë e fenomenit të antigjipsizmin.

Samiti "Së bashku dhe të barabartë"

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ka organizuar Samitin Rajonal Kundër Diskriminimit Racor më 7 nëntor 2023, qëllimi i Samitit ishte shkëmbimi i përvojave me qeveritë e vendeve të rajonit, lidhur me veprimet që kanë ndërmarrë për luftimin e racizmit dhe diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe për të diskutuar mënyrat për të thyer ciklin e përjashtimit social.

Slogani i Samitit ishte "Së bashku dhe të barabartë".

Objektivi specifik 5.3 Rritja përfshirjes së komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimit të publikut dhe zyrtarëve publik për racizëm dhe kundërdiskriminim ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali si dhe promovimin e historisë dhe kulturave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në sferën publike.

MKRS ka ndërmarr disa aktivitete për rritja përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali përmes vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimit të publikut dhe zyrtarëve publik për racizëm dhe kundërdiskriminim ndaj komuniteteve rom dhe ashkali si dhe promovimin e historisë dhe kulturave të komuniteteve rom dhe ashkali në sferën publike.

MKRS ka publikuar listat me projekte përfutuese të thirrjeve publike të shpallura në web të MKRS: <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,114>;

Thirrjet publike të shpallura nga MKRS gjatë vitit 2022 të profilizuara në art dhe trashëgimi kulturore; rini janë si në vijim;

1. Thirrje publike: Art dhe Trashëgimi kulturore I & II;
2. Thirrje publike: Mobiliteti- Kulturë, Rini, Sport, Trashëgimi;
3. Thirrje publike për propozime në Rini;
4. Thirrje publike: Mundësi të barabarta për të gjithë Art, Trashëgimi Kulturore dhe Rini;

5. Thirrje publike për botimin e librave/revistave, blerje

Pra, sipas të dhënave nga MKRS projektet e përkrahura financiarisht nga MKRS për vitin 2022 për k-rom dhe k-ashkali janë:

1. Përparimi i komuniteteve-PERKOM "Martesat rome, veshjet rom dhe zejjet tradicionale" 5,000.00 €.
2. Roma Versitas Kosovo- "Empowered Roma, Empowered Kosova" 5,610.00 €.
3. Avansimi i pozitës së Komuniteteve "Angazhimi vullnetarë i të rinjve, mundësi e mirë për të promovuar vullnetarizmin" 5,510.00 €.
4. Sakuntala- "Zëri i të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian për një të ardhme më të mire" 5,972.50 €.
5. Durmish Aslano "Hulumtimi mbi përdorimin e mediave nga të rinj e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas" 5,340.00 €.
6. Sh.B. BAF botim dhe revista "Yekhipe" Indira Elshani/Sakuntala 1,000 €.

Gjatë vitit 2022 gjithsejt 6 organizata/operatore kulturor të k-rom dhe k-ashkali janë financuar nga MKRS, me shumën totale prej: 28,432.50 €.

Në Komunën e Prizren-it me 31 tetor 2022 është shpallur gjuha rome si gjuhë zyrtare. Kjo është vlerësuar nga kryetari i komunës që ky komunitet ka trashëgimi unike dhe ndër prioritetet e Komunës është mbrojtja e të drejtave të komuniteteve si dhe e të gjithë qytetarëve të Komunës së Prizrenit, pa dallim.

Gjatë vitit 2022, Zyra për Çështje të Komuniteteve ka ndarë 2 grante për OJQ për projekte të komuniteteve rom dhe ashkali. Gjithashtu, në shkurt të vitit 2023, Zyra për Çështje të Komuniteteve ka ndarë 10.000 euro për festimin e ditës së ashkalive.

Gjithashtu, janë ndarë grante nga ZÇK-ja për 3 projekte për punë me media të komuniteteve rom dhe ashkali gjatë vitit.

Zyra e kryeministrit gjegjësisht keshilltarja e Krzeminitrit për komunitete ka punuar në vazhdimësi me Komunitet në nivel komunal ose/ edhe Zyrtareve Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe institucioneve qendrore për zgjidhjen e problemave, duke krijuar një urë lidhëse mes institucioneve të nivelit qendror dhe lokal. Janë vizituar dhe janë zhvilluar takime me përfaqësues të komuniteteve rom dhe ashkali në 11 komuna dhe ku edhe janë ngritur ceshtje sic janë bursat dhe riparimi i rrugave në lagje të komuniteteve.

Gjithashtu, Kryeministrit ka ftuar të gjithë Zyrtaret Komunal për Komunitet dhe Kthim për të ndigjuar prej tyre për prioritetet nga niveli komunal për komunitetet, ju janë informuar nga Kryeministri për aktivitetet e Qeverisë së Kosovës. Mbas asaj është organizuar edhe një takim të tillë për ndarjen e praktikave të mira më Zyrtarët Komunal për Komunitete dhe Kthim.

Kryeministrit ka ftuar një takim tjetër përfaqësues të shoqërisë civile të komunitetit rom, bashkë me përfaqësues politike në një takim të veçantë ku janë ndërgjuar pjesëmarrësit për prioritetet dhe

